

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---------------------------|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti Filozofik - Departamenti i Historisë |
| Titulli i lëndës: | Histori moderne shqiptare 1878-1912 |
| Niveli: | Bachelor |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | 2013/2014, Viti i tretë (III), Semestri VI |
| Numri i orëve në javë: | 3+2 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 6 |
| Koha / lokacioni: | Sipas orarit të paraparë në fillim të semestrit |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. Asoc. Dr. Bujar Dugolli |
| Detajet kontaktuese: | bujar.dugolli@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | <p>Lënda Histori moderne shqiptare 1878-1912, ofron njohuri themelore mbi ngjarjet, fenomenet dhe proceset historike, që shënuan fillimet e krijimit të shtetit kombëtar shqiptar. Vëmendja do të përqendrohet kryesisht në fenomenet nga fusha e zhvillimit të mendimit politik, shoqëror, kulturo-arsimor, religjioni, rregullimi politik, diplomacia shqiptare dhe ndërkombëtare, ekonomia, tregtia etj. të cilat kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe historike. Shek. XIX dhe fillimet e shek. XX për popullin shqiptar shënojnë një epokë të re, atë të ndërtimit dhe të formimit të shtetit shqiptar. Shekujt, XIX dhe XX kanë hyrë në historinë moderne të vendeve të Ballkanit si shekujt e lëvizjeve dhe të revolucioneve kombëtare, që ndoqën njëri-tjetrin dhe që çuan në çlirimin e shumicës së popujve të këtij gadishulli nga zgjedha e Perandorisë Osmane . Këto lëvizje u zhvilluan në kushtet e shturjes së Perandorisë Osmane; të shturjes së marrëdhënieve të vjetra feudale dhe të lindjes së ekonomisë së tregut (kapitalizmit); të zgjimit të mëtejshëm të ndërgjegjes kombëtare të popujve të këtij gadishulli dhe të zgjerimit të ndërhyrjeve të Fuqive të Mëdha në këtë perandori, por edhe tek vendet e Ballkanit. Historia moderne shqiptare 1878-1912 përbën një lëvizje të gjithanshme kombëtare, me një përmbajtje të re ideologjike, politike, kulturore, ekonomiko-shoqërore dhe organizative që kulmoi me formimin e shtetit shqiptar. Ajo synonte të zgjidhte detyrat që i takonin çështjes kombëtare; të çlironte vendin nga sundimet e huaj osmanë; të bashkonte trojet shqiptare në një shtet të vetëm e të pavarur; t'i ndalte ambiciet e fqinjave ballkanikë</p> |

| | |
|----------------------------------|--|
| | ndaj tokave shqiptare; të hapte rrugë e zhvillimit dhe përparimit ekonomiko-shoqëror, politik e kulturor të Shqipërisë etj. |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve, do të synohet që studentët, jo vetëm të marrin informacionin e duhur, por edhe të nxiten për diskutime dhe analiza të pavarura rreth tematikës që do të shtjellohet gjatë procesit mësimor.</p> <p>Përmes kësaj metodologjie studentet do arrijnë t'i kuptojnë zhvillimet politike dhe kulturore në kohën e konsolidimit të kombit shqiptar, vështirësitë që i kishte Lëvizja Kombëtare Shqiptare në raport me Perandorinë Osmane, por edhe përgjigjen që i dha Lëvizja Kombëtare Shqiptare aspiratave pushtuese të disa popujve të Ballkanit.</p> <p>Pas përfundimit të këtij kursi studentët do mund të njohin më mirë historinë kombëtare, në periudhat e lartpërmendura, do të aftësohen për të bërë analiza dhe kritika, me qëllim të vlerësimeve sa më të drejta historike, do njohin më mirë politikën, por edhe diplomacinë e Fuqive të Mëdha dhe popujve fqinjë të shqiptarëve.</p> <p>Ky është qëllim, por edhe objektivi i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës për edukimin edhe avancimin e arsimit të lartë në Kosovë.</p> |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | <p>Nga kjo lëndë studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të kuptojnë drejt se pse kjo periudhë quhet <i>Histori moderne shqiptare</i> në përkufizimet 1878 -1912 dhe çka ndodhi gjatë kësaj periudhe; • Do ta kuptojnë dhe do të mësojnë ta interpretojnë drejt fenomenin e ngritjes së <i>çështjes shqiptare</i> në Ballkan, në raport me rrethanat e asaj kohës (shthurjes së Perandorisë Osmane dhe lindjes së shteteve të reja në Ballkan, posaçërisht shtetit shqiptar). • Do ta kuptojnë ndërlidhshmërinë dhe komparacionin e fenomeneve ekonomike, sociale, kulturore, politike dhe religjioze te shqiptarët. • Do të jenë në gjendje të diskutojnë mbi konceptet themelore të shkencës moderne, |

| | | | |
|---|--|-----------|-----------------------|
| | <p>duke i marrë për bazë veprat monumentale të rilindësve tanë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të jenë në gjendje t'i kuptojnë dhe t'i diskutojnë fenomenet e ndryshme shoqërore të asaj kohe dhe qëndrimin e klasës politike e intelektuale të shqiptarëve të asaj kohe. • Do të kuptojnë për raportet e shqiptarëve me Perandorinë Osmane dhe fqinjët ballkanikë. • Do të mund të analizojnë dhe të krahasojnë raportet e diplomacisë ndërkombëtare, sa i përket <i>çështjes shqiptare</i> në Ballkan. • Do të mund të analizojnë rrethanat në të cilat u krijua shteti shqiptar etj. | | |
| Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 3 | 15 javë | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 2 | 15 javë | 30 |
| Punë praktike | - | - | - |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 0.30 | 10 javë | 3 |
| Ushtrime në terren | - | - | - |
| Kolokviume, seminare | 2 | 4 javë | 8 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 1 javë | 1 |
| Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 ditë | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 15 ditë | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 2 | 1 javë | 2 |
| Projektet, prezantimet etj | 1 | 1 ditë | 1 |
| Totali | | | 150:25= 6 ECTS |
| Metodologjia e mësimdhënies: | <ul style="list-style-type: none"> - Ligjërata (<i>forma e kombinuar – interaktive</i>) - Ushtrime (<i>hartimi i punimeve shkencore, diskutimi i tyre në grupe dhe komunikimi interaktiv, lidhur me punimet e studentëve</i>) - Komunikimi përmes internetit dhe konsultimet e parapara në ditët përkatëse - Verifikim i dijes përmes testimit dhe provimeve me gojë dhe me shkrim. | | |
| | | | |

| | |
|-----------------------|---|
| Metodat e vlerësimit: | -- Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata ----- 10 % - Pjesëmarrja aktive në diskutime gjatë ligjëratave ----- 15 % - Angazhimi me më shumë se 3 ese----- 20 % - Provimi final - me gojë dhe me shkrim ---- 55 % Totali -----100 % |
| Literatura | |
| Literatura bazë: | - <i>Historia e popullit shqiptar</i> [2002] II, Tiranë. - <i>Akte të Rilindjes Kombëtare</i> [1978], Tiranë. - Frashëri, Sami [1978], <i>Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet</i> , Bukuresht 1899 dhe ribotim, Prishtinë. - Dugolli, Bujar [2011], <i>Marrëdhëniet shqiptaro-serbe 1878-1912</i> , Prishtinë. - Skendi, Stavro [2000], <i>Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912</i> , Tiranë. - Shpuza, Gazmend [1980], <i>Gjurmime në epokën e Rilindjes Kombëtare</i> , Tiranë. - Frashëri, Kristo [1997], <i>Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881</i> , Tiranë. - Braha, Shaban [1991], <i>Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844-1990</i> , Tiranë. - Cana, Zekeria [1990], <i>Populli shqiptar në kapërcyell të shekullit XX</i> , Prishtinë. - Prishtina, Hasan [1921], <i>Një shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen e vitit 1912</i> , Shkodër. - Puto, Arben [1987], <i>Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare II</i> , Tiranë. - Puto, Arben [2003], <i>Historia diplomatike e çështjes shqiptare</i> , Tiranë. - Vlora, Eqrem Bej, [2001], <i>Kujtime, vëllimi i parë 1885-1912</i> , Tiranë. - Myzyri, Hysni [1996], <i>Arsimi Kombëtar Shqiptar 1908-1912</i> , Tiranë. Rizaj, S. Gazmend [2011], <i>Shqipëria e Sipërme 1800-1913</i> , Instituti Albanologjik, Prishtinë. - Dugolli, Bujar [2008], <i>Drenica në kthesat historike të Ballkanit 1908-1912</i> , Prishtinë. |
| Literatura shtesë: | a. Literatura e autorëve të huaj: - Malkolm, Noel [1998], <i>Kosova- një histori e shkurtë</i> , Prishtinë. - Bartle, Peter [1999], <i>Shqipëria nga mesjeta deri</i> |

| | |
|--------------------------------|---|
| | <p><i>më sot, Prizren.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Biagini, Antonella [2000], <i>Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët e tona</i>, Tiranë. - Durham, Edith [2000], <i>Brenga e Ballkanit</i>, Tiranë. - Durham, Edith [1913], <i>The struggle for Scutary</i>, London. - Durham, Edith [1920], <i>Twenty Years of Balkan Tangle</i>, London. - Hrabak, Bogumil [1988], <i>Arbanski upadi i pobune na Kosovo i u Makedoniji od kraja 1912 do kraja 1915</i>, Vranje. -Metais, Serge [2006], <i>Historia e shqiptarëve nga ilirët deri te pavarësia e Kosovës</i>, Tiranë. - Glenney, Misha [2007], <i>Histori e Ballkanit 1804-1999, Nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha</i>, Tiranë. - Jacques, Edwin [1995], <i>Shqiptarët: Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme</i>, Kartë e Pendë, Fondacioni Abraham Linkoln, Tiranë (Titulli i origjinalit: <i>The Albanians: An Ethnic History from Pre-Historic Times to the Present</i>, Copyright 1995 Edwin E. Jackues). - Karpat, H. Kemal [2002], <i>The Politicization of Islam. Reconstructing Identity, State, Faith, and Community in the Late Ottoman State</i>. - Aref, Mathieu [2007], <i>Shqipëria (Historia dhe Gjuha) Odiseja e pabesueshme e një populli parahelen</i>,Tiranë. - Stanford J. Shaw, [2006], <i>Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë moderne</i>,Tiranë. <p>b. Revistat shkencore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - VJETARI, Arkivi i Kosovës, Prishtinë. - Gjurmime Albanologjike, Seria e Shkencave Historike, Prishtinë. - BULETINI, Fakulteti Filozofik, Prishtinë. - Studime Historike, Instituti i Historisë Tiranë dhe Prishtinë. <p>c. Burimet kredibile nga interneti.</p> |
| Plani i dizajnuar i mësimimit: | |
| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
| Java e parë: | <ul style="list-style-type: none"> • Njohja me lëndën; burimet dhe literatura; vështrim i |

| | |
|----------------------|--|
| | <p>përgjithshëm mbi periudhën që e karakterizon <i>historinë moderne shqiptare 1878-1912</i>. Vendimet e Kongresit të Berlinit dhe copëtimin i territoreve të Shqipërisë.</p> |
| Java e dytë: | <ul style="list-style-type: none"> Mbrojtja e kufijve jugorë. Mbrojtja e Plavës dhe Gucisë (dhjetor 1879 - janar 1880). Mbrojtja e Hotit dhe Grudës (prill 1880). Lufta për mbrojtjen e Ulqinit. |
| Java e tretë: | <ul style="list-style-type: none"> Kuvendi i Gjirokastrës (korrik 1880) dhe ai i Dibrës (20 tetor 1880). Formimi i Qeverisë së Përkohshme Shqiptare dhe veprimtaria e saj. |
| Java e katërt: | <ul style="list-style-type: none"> Lufta e Lidhjes së Prizrenit kundër ushtrisë osmane. Rëndësia e Lidhjes së Prizrenit. |
| Java e pestë: | <ul style="list-style-type: none"> Arsimi dhe kultura në vitet 1882-1908. Ndikimi i Lidhjes së Prizrenit në lëvizjen arsimore dhe kulturore. Alfabeti i Stambollit. Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip. Hapja e shkollave kombëtare në Shqipëri. Shkolla e Prizrenit. |
| Java e gjashtë: | <ul style="list-style-type: none"> Lidhja e Pejës. Rreziqet e reja të copëtimin të tokave shqiptare. Kërkesat për autonominë e Shqipërisë (1896-1898). Lidhja e Pejës dhe Kuvendi i Dibrës. |
| Java e shtatë: | <ul style="list-style-type: none"> Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe <i>turqit e rinj</i>. Ndihmesa e shqiptarëve dhe Revolucioni Xhonturk. |
| Java e tetë: | <ul style="list-style-type: none"> Zgjerimi i veprimtarisë arsimore dhe kulturore brenda vendit. Kongresi i Manastirit dhe ai i Elbasanit. |
| Java e nëntë: | <ul style="list-style-type: none"> Kryengritja e Kosovës e vitit 1910. Kongresi i Dibrës dhe kërkesat e tij politike kombëtare. Përballimi me reaksionin xhonturk. Fillimi dhe përmasat e kryengritjes së Kosovës. Shpërthimi i terrorit xhonturk në Kosovë, Shqipërinë e Sipërme dhe të Mesme. |
| Java e dhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> Kryengritja e Malësisë së Madhe e vitit 1911. Shpërthimi i kryengritjes së vitit 1911. Memorandumi i Greçës. Bisedimet shqiptaro-turke të Podgoricës dhe Tepelenës. |
| Java e njëmbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> Shpërthimi i Kryengritjes së përgjithshme të vitit |

| | |
|-----------------------|---|
| | 1912 |
| Java e dymbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Kuvendi i Junikut dhe kërkesat për autonomi. Bisedimet shqiptaro-turke. |
| Java e trembëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Vendi i kryengritjeve shqiptare të vitit 1910-1912 në rrafshin ballkanik. |
| Java e katërbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Aleanca Ballkanike dhe shqiptarët. Lufta e Parë Ballkanike dhe Shqipëria. |
| Java e pesëmbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> • Kuvendi i Vlorës dhe Shpallja e Pavarësisë. Rëndësia historike e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë 28 nëntor 1912 |

| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes*: |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • Hyrja me kohë në ligjërata - e domosdoshme. • Vonesa mbi 10 minuta nuk justifikohet; • Telefonat celularë shkyçen para se të fillojë procesi mësimor; • Kopjimi gjatë provimit final - i ndaluar dhe ndëshkohet; • Shfrytëzimi jo i drejtë i burimeve (plagjiati etj.) me rastin e hartimit të eseve, punimeve seminarike etj. i ndaluar dhe ndëshkohet; <p>Çdo kontakt me profesorin e lëndës, lidhur me çështjet që dalin nga lënda përkatëse - nëpërmjet e-mail adresave, ditëve të parapara për konsultime dhe në raste urgjente edhe përmes telefonit.</p> <p><i>* Statuti i Universitetit të Prishtinës i cili është në fuqi parasheh politikat e mirësjelljes dhe misionin e Universitetit.</i></p> <p><i>Ne do t'i përmbahemi këtij statuti, njëherësh kërkojmë që edhe studentet të jene të përkushtuar në respektimin e aktit më të lartë normativ të Universitetit të Prishtinës.</i></p> |

© Bujar Dugolli, të gjitha të drejtat të rezervuara.